



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
MBLEDHJA E GJYQTARËVE

Nr. 92/11 Prot.

Datë 02.12.2025

V E N D I M

Nr. 11, datë 02.12.2025

**“PËR NISJEN E PROCEDURAVE PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË GJYKATËS  
KUSHTETUESE”**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                      |           |
|----------------------|-----------|
| Marsida Xhaferllari, | Kryesuese |
| Fiona Papajorgji,    | Anëtare   |
| Sonila Bejtja,       | Anëtare   |
| Sandër Beci,         | Anëtar    |
| Ilir Toska,          | Anëtar    |
| Genti Ibrahim, i,    | Anëtar    |
| Marjana Semini,      | Anëtare   |
| Asim Vokshi,         | Anëtar    |

e mbledhur në datën 02.12.2025, bazuar në nenit 7/d të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000), si dhe neneve 9 dhe 10 të të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (Rregullorja),

V Ë R E N:

1. Me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024 Gjykata Kushtetuese ka vendosur deklarinimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese zonjës Holta Zaçaj, në datën 10.03.2025.
2. Me vendimin nr. 2, datë 30.09.2025, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë ka vendosur zgjedhjen e zotit Asim Vokshi në detyrën e Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili në datën 25.11.2025 ka bërë betimin para Presidentit të Republikës.
3. Në përputhje me nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese fillon detyrën pasi bën betimin para Presidentit.

4. Me zgjedhjen e anëtarit më të ri, ka përfunduar ushtrimin e detyrës si anëtare e Gjykatës Kushtetuese zonja Holta Zaçaj, e cila njëkohësisht ushtronte edhe detyrën e Kryetares së kësaj Gjykate.

5. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), çmon se duhet të fillojë procedurat për zgjedhjen e Kryetarit të ri. Në kushtet kur vendi ka mbetur vakant, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se afatet e parashikuara nga Rregullorja duhet të përgjysmohen, në përputhje me përcaktimet e pikës 6 të nenit 9 të këtij akti.

### PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në mbështetje të neneve 7/d të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe neneve 9 dhe 10 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

### VENDOSI:

- Fillimin e procedurave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
- Kërkesa me shkrim për shprehje interesi nga gjyqtarët mund të paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 02.12.2025

ANËTARE

  
/Sonila Bejtja/

ANËTARE

  
/Fiona Papajorgji/


KRYESUESE

  
/Marsida Xhaferllari/

ANËTAR

  
/Gent Ibrahimi/


ANËTAR

  
/Ilir Toska/

ANËTAR

  
/Sandër Beci/

ANËTAR

  
/Asim Vokshi/

ANËTARE

  
/Marjana Semini/